

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. _____ Prot

Vlorë, më: ____ . ____ 2023

DËGJESË PUBLIKE
MBI PAKETËN FISKALE ME BIZNESET (HOTELERI) NË VLORË

Data 24.11.2023: ora 17.00

Në Pallatin e Kulturës "Labëria"

Marrin pjesë:

Nën Kryetari i Bashkisë Vlorë, Elpiniqi Mërkuri -Kryetare e Këshillit Bashkiak, Anëtarë të KB, përfaqësues biznesesh, hoteleri .

Vasil Bedini: Përshendetje, ju falënderoj për organizimin e këtyre tryezave. Te plazhet, Nartë –Plazhi i Vjetër , 25 %-60%.

Motta – Radhimë-60%. Me vitet që drejtoj biznes, pra më thoni për këtë rritje, argument, asnjë ligj nuk ta lejon rritjen 30 %. Ne qoftëse do kemi ngritje 30%, 60% në fund të fundit, do ta ndjejmë ne në kurriz. Përsa i përket hotelerisë, shtretërit...të gjithë bashkë bëjnë 800 dhoma si resort. Ky qytet ka nevojë për më shumë punë.

Vasil Bedini: Sa e ke numrin të rregjistruar në 6 mijë e ca subjekte në booking.

Anjeza Shiko: Asnjë

Vasil Bedini: 60% janë tatimpagues, ta cojmë në 75%, por të na i ulni tarifatat, jo të rriten. I kemi listat, tjuaj sjellim për regjistrim.

Zv Kryetar-A keni bërë ndonjë kërkesë?

Vasil Bedini: identifikimi sit ë paregjistruar është shumë e thjeshtë. Keni nevojë , keni nevojë por sduhet të tkurni kërkesat për..i rishikoni plazhet. Përpikuni që të shtrihemi horizontalisht jo vertikalisht.

Zv/kryetar: plazhet janë taksuar, nuk mund të ndikoj shumë ai 100%

Vasil Bedini: Të shtohen shtresat akomoduese. Në paketë me mëngjes dhe plazh. Ky ekuacion zgjidhet me kategorizim.

Dorian Demiri: Kush është sygjjerimi juaj?

Vasil Bedini: Kategorizimi me bazë të nr të dhomave. Uji ma ken grit por mos ngri dhe plazhin. (llogartiti dhomat, zhezllo dhe plazh) pra duam të konkurojmë taksën e plazheve.

Anjeza Shiko: faleminderit pasi jeni bërë pjesë. Tarifat janë bërë me kategorizim për vitin 2024 të ndahen në 4 zona. Rritjet që janë bërë. Sezoni turistik 6 muaj, me VKM ...83L/m2 ku jemi bazuar.

Vasil Bedini: mos fusni taksën për fjetje.

Anjeza Shiko: Aplikoni te Agjencia. Nis nga Agjencia Bregdetit pastaj fillon me faturë që e ka bashkangjitur VKM për plazhet publik. Çmimet në këtë vit janë rritur, cadrat, tarifa është rritur, hoteleria nuk e shet.

Biznes: Për Radhimën, pas punimeve që do bëhen do jetë kaos.

Anjeza Shiko: nuk janë rritur tarifat. Taksa e ndërtimit është rrit apo dhe tarifa e pastrimit ka nevojë për tu riparë.

Biznes: Rritja në Radhimë në 30% është shumë, janë aktualisht punime, do jetë kaos.

Vasil Bedini: plazhi public dhe privat është ngjyrë gri. Në Radhimë ska plazh public. E ke ndarë 70-30 për publikun.

Anjeza Shiko: ai aplikon për të gjithëdhe me 30%.

Vasil Bedini: 16m2 me gjithë rrugët, e respekton për 200

Anjeza Shiko: Krahasimet me Ksamilin

Vasil Bedini: Sa ma rrit cmimin e dhomës?

Anjeza Shiko: Do parë VKM do bashkëpunim..verifikimi rast pas rasti. Nje standart 1000 l/m për hotelet jo 5,6 apo 7.

Biznes: S'ka as taksë fjetje.

Anjeza Shiko: 500 lek nuk do ngelet por as 1000 do ta shohim, bizneset i kemi partner. Kryetari pretendon që ka bërë pastrimin. Të ndihmojmë njëri tjetrin,

Vasil Bedini: Kategoizimi Plazhi i Vjetër, Zvërnec, zona e Radhimës.

Anjeza Shiko: Plazhi dhe SPL

Vasil bedini: Sa është m2 në një lokal në Lungomare me qira. 25 euro/m2 pa 2500 euro nuk merret.

Anjeza Shiko: E rinisim të mbyllurat, tendat. Ne sot po bëjmë një rregullim për cada dhe kush të mbyllura me 1000 lek.

Vasil Bedini: Projektioni në Lungomare të rezistoj ashtu sic është bërë. Ata me tendë të paguajnë tarifën.

Anjeza Shiko: Do bëhet një kategorizim

Vasil Bedini: Ai që ka bërë tendë mos të paguaj njësoj me atë që se ka bërë tendën. Fasha 150 ditë, ska asnjë që të paguajë 150 ditë në Radhimë. Ska transport urban për në Radhimë.

Anjeza Shiko: Sa ditë mendon se punon Radhima?

Vasil Bedini: 100 ditë.

Anjeza Shiko: Në diskutim të taksës së hotelit kemi hasur vështirësi. Në moment që nuk dorëzohen regjistrimet, do penalizohen me nje tarife afrofe. 175 ka qënë, ju jeni me 70 tërë kohën.

Vasil Bedini: Nje hotel me 100 dhomax150 ditëx70- I mil për rata që nuk sjellin regjistrat.

Kam 100 dhoma për 150 ditë po të mbledh të gjitha x 140. Unë që sjell regjistrimet. Pra pse do sjell regjister?

Anjeza Shiko: Na ndihmoni për regjistrimet ne booking.

Vasil Bedini: Për plazhin ulni fashën, për Radhimën dhe Zvërnecin

Anjeza Shiko: është me VKM, ka një paketë ligjore.

Vasil Bedini: Zonën B bëjeni 120. Të instalohet tek recepsioni tarifa e fjetjes së hotelit automatikisht. Të instalohet ky program në Bashkia Vlorë. A bëhet dot kjo? Maksimumi 30%.

Anjeza Shiko : Pra, kërkoni rritjen e taksës, me ato me tendë, ndryshimi i tarifave me ata pa tendë..... Lutemi , na i sillni me shkresë ndryshimet dhe propozimet, për të cilat mendoni dhe, vendosim.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ Prot

Vlorë, më: ____ . ____ 2023

DËGJESË PUBLIKE

**MBI TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE,
PËR VITIN 2024**

Në Pallatin e Kulturës "Labëria"

Data 17.11.2023: ora 11.00

Marin pjesë:

Ermal Dredha-Kryetari i Bashkisë Vlorë,

Irena Toshkallari-nënkryetare e Bashkisë Vlorë,

Novruz Rrokaj-Nënkryetari i Këshillit Bashkiak,

Anëtarë të KB,

Anjeza Shiko-Drejtoreshë e Taksave.

Përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë, Unioni i Turizmit, përfaqësues nga bizneset e hotelerisë, shoqëria civile.

Dëgjesa u hap nga z. Ermal Dredha-Kryetari i Bashkisë Vlorë, i cili parashtrroi në fjalën e tij:

Përshëndetje!

Ju falenderoj për prezencën në takim. Kemi një muaj në vazhden e takimeve të projektbuxhetit si një proces transparent me pjesëmarrjen e publikut. Sot jemi mbledhur për paketën fiskale të vitit 2024.

Ka hapësira për përmirësim. Prioritet është tarifa për tokën bujqësore – 30%. Si eksperte do ju flasi drejtoresha e taksave në bashkinë Vlorë. Ka ndryshime taksa në infrastrukturë. Është e arsyeshme, në reformën e taksave që ti japim mundësi zhvillimeve në qytet. Dua, zhvillim por duhen dhe arkëtimet. Marrim referencë precedentët dhe do respektohet tavani dhe dysHEMEJA E ligjit të taksave. Tarifat për furnizimin e ujit të pijshëm kanë qënë kërkesë e vazhdueshme nga AKUMI në rang vendi. Vlorë është nga qytetet e fundit me këtë nivel të tarifave.

Qëllimi ynë janë përmirësimi i investimeve dhe shërbimeve publike!
Po ja kaloj fjalën znj Anjeza dhe më pas diskutojmë.

Anjeza Shiko-Dr. Taksave Vendore-Bashkia Vlorë. Ju falenderoj për pjesëmarjen. Në vëjimësi do paraqesim paketën fiskale të vitit 2024. Baza është buxheti i vitit 2024. Të ardhurat janë investim dhe shërbim public për qytetin e Vlorës. Baza ligjore është Ligji për tatimin, ligji për të ardhurat vendore, Ligji i Vetqeverisjes vendore. Paketa në vetvete s'ka ndryshim por ka disa saktësime. Ka rritje në disa pika sepse Bashkia Vlorëka tarifat me të ulta edhe nga qytetet e tjera. Te pastrimi është sektori i gjelbërimit dhe ndricimit që preken. Largimi i mbetjeve dhe pastrimi do jone sektorë më vete. Kostua që ka bashkia për pastrimin mbulon vetëm 17%-21% të tarifës së pastrimit. Bashkitë e tjera janë më të larta.

Bizneset në bashkitë e tjera i kanë tarifat me të larta krahasuar me bizneset në Bashkinë Vlorë.

Bashkia Vlorë 7202 lekë- 54 mijë

Bashkia Selenicë 115

në % është 50% më e ulët.

Bashkia Vlorë është me tarifata dhe taksat vendore më të ulta në Shqipëri. Ndërkohe Bashkia Elbasan 587.

Bashkia Vlorë 54489. Në 5 vitet e fundit janë ndryshuar të tjerat dhe pastrimi jo.

Tarifa për biznesin e vogël në lidhje me pastrimin nga 7300 lekë bëhet 10.000 për vitin 2024.

Pra është një rritje prej 225 lekë/muaj. Për bizneset e vogla është e papërfillshme, ndërkohë për bizneset si librari, kancelari është një rritje e ulët..

Janë përjashtuar OJF. Kategoria familje mbetet e paprekur nga rritja e tarifës së pastrimit.

Ndikimi në infrastrukturë.

Altin Karalliu/Pyetje nga salla: Nuk janë të thelluar argumentat që na paraqitetet. Krahasimet me qytetet e tjera dhe Vlorën nuk jemi dakort. Nuk na duhet. Ajo qëna duhet është një analizë cmim/kosto. Janë rritur kostot. Ok. E ndjejmë dhe ne. Ka biznese që paguajnë dhe disa nuk paguajnë. Janë rreth 30-40% e bizneseve që se paguajnë, janë informal. Zgjeroni numrin e tatimpaguesve, jo vetëm ata që paguajnë, të vazhdojnë të paguajnë.

Anjeza Shiko: Ka rritje! Kjo kosto ka dal nga mbetjet.

Ermal Dredha: Sezoni ka dyfishuar kostot për mbetjet, nga numri i lartë i turistëve, ka patur ndotje dhe patjetër ka kërkuar angazhimin e strukturave përgjegjëse. Fluksi është rritur. Tarifata janë llogaritur sipas ligjit dhe sudimit të bërë nga KFW. Si e prezantoi Anjeza rreth 17%. Hamë më shumë e paguajmë më pak. Projektioni duhet 50-50. Vlorë kërkon shërbim. Sa zbatues jemi vjercarpër vjeljen e taksës? Ka handicap. Cfarëi takon qytetarit do paguhet.

Zonja Qytetare/Pyetje: Ne qoftëse do bëhet investimi duhet të dal ligji dhe për qytetet do të doja koshat të shtohen, të bëhet ndarja e mbetjeve....

Ermal Dredha: Numri i ikoshave, buxheti. Duhet të shtohen. Ladfilli është firmos, do merret në dorëzim. Deri në pranverën tjetër do vihen në punë. Në zonat më të frekuentuara do shtohen

koshat. U planifikuan për PB e vitit 2024. Ka filluar fushata për ndërjegjësimin e komunitetit dhe biznesit, për mbetjet karton. Mbledhja dhe formatimi ityrë nga bizneset që gjenerojnë të tilla mbetje.

Zonja Pyetje- Administratorët e pallateve në lidhje me bolierët çfarë do bëhet?

Vasil Bedini: Faleminderit. Fillimisht jemi të pakënaqur sepse ska përfaqësues të bizneseve të vogla në këtë takim. Saështë % e bizneseve të turizmit dhe sa ka të vogla? Duam draftin për ta parë dhe nuk naështe vënë në dispozicion. Sa ndikohet biznesi I madh dhe I vogël nga rritja e tarifave? Na jepni materialin ta studiojmë dhe diskutojmë. Të fokusohemi te turizmi jot e Corovoda! Na dërgoni me email materialin. Organizoni tavolina me grupe interesi sipas sektorëve. Nuk jemi kundra, jemi bashkëpunues me ju. Sa punonjës ka gjelbërimi? Sa janë me letra? Kyështë fillim i ri dhe jeni të mirëpritur për të bërë gjërat sic duhen bërë.

Ermal Dredha: Faleminderit. Kjo është dëgjesë e hapur dhe ka pjesëmarrës aq sa mban dhe salla. E drejtë! Do të organizohen takime të vecanta me grupe interesi, turizmi.

Anjeza Shiko: Takimi është dëgjesë dhe diskutim për sot. Do ju vendosim një kopje në dispozicion materialin e hartuar nga administrata.

Ervin Sota/Biznes: jemi mbledhur kemi diskutuar dhe keni bërë tjetër gje. Përpara se ti rrisim na mblidhni dhe ti diskutojmë. 2251/muaj është ok. Por taksat të mblidhen 100% jo vetëm në Lungomare. Të diskutohet me shifra.

Anjeza Shiko: informacionin që kërkoni do jua japim. Takimet e tjera do bëhen dhe do i diskutojmë. Analiza financiare e bashkisë është sipas këtyre shifrave. Ligji ka penalitete për bizneset që nuk i paguajnë. Drafti i paketës fiskalë është bërë njoftim public për pjesëmarrjen.

Irena Toshkallari. Nëse doni ju mbledhim sipas një kalendari.

Anjeza Shiko: Janë të dhënat e parashikuara në buxhetin e bashkisë..ka biznese që nuk paguajnë, ata që spaguajnë ka penalitete. Një pakicë e vogël janë debitor. Të tjerët I paguajnë.

Kalojmë të ndikimi në infrastrukturë.

Klaudio Mehmeti-Drejtor i Urbanistikës: Përshendetje. Paketa fiskale 2024 në lidhje me taksën për ndërtime e reja është parashikuar: nga viti 2019 për ndërtime në vijën eparë ishte 8% dhe për zonat e tjera ishte 4%.

Krahasime: Durrës e ka 8% në gjithë qytetin, B.Shkodër-4% në gjithë qytetin, Vorë-8%.

Në Vlorë është e ndarë me zona, 8% është në Lungomare. Do e zgjerojmë si zonë Lungomare 2.

Taksa e ndërtimeve në zonat e tjera do rritet nga 4%-6%, për banesat, shërbimet por jo për hoteleri.

Vija e parë dhe shtrirja që ka marr sot. Orikumi nuk është prekur taksa në infrastrukturë. Subjektet me deklaratë paraprake, marrin leje zhvillimi. Në 2023 ...aplikime 1000 familjarë, 500 leje zhvillimi në vit.

Ka një vlerë që ndikon. Shyrtimi i aplikimeve dhe si volum dokumentacioni. Është propozuar një rritje e ndarë.

Objekte –Leje zhvillimi 5000 mijë

Deklaratë paraprake 5000
Objekte e larta-10 mijë
Shoqërite e tjera-15 mijë.

Trajtimi për llogaritjen e taksës. Deri sot tarifa është llogaritur mbi të gjithë sipërfaqen. Tani do të jetë vetëm për sipërfaqen e banimit, dhe jo për ambientet e përbashkëta. Pra ka një ndikim – 10-12%.

Ermal Dredha: Pra 1% rritet, nuk do trajtohen ambientet e përbashkëta.

Arben Breshani: Faleminderit kryetar. Ana ligjore. Tavolina teknike me ekspertë duhen bërë për të kuptuar çfarë ndikimi do kenë këto rritje në cdo sektoë. Duhet studim i detajuar. Rritja nga 4-6%. Ndikimi ku është? Zona në zhvillim në Lungomare, Radhimë.

Altin Karalliu/Biznes: Flas në emër të shoqatës të ndërtuesve. PB financiar duhet ti ketë, të jetë public në faqen e bashkisë. Rritja e taksës së sheshit të ndërtimit do e frenoj ndërtimin apo do e rrit nr? Me këto taksa ka rritur. Investitori strategjik e merr 1 euro ndërsa ne startojmë me më shumë 8%. Ne do punojmë apo do pastrojmë lekët? Na vini në vështirësi ekonomike. Duhet diskutuar me grupet e interest.

Degjova nga z. per deklaratat paraprake etj ndodh që mund të bëhet aplikimi për 4 herë pra tarifat rriten. Keni vënë disa tarifa të tjera. Të gjitha këto ligji I ka saksionuar, pra nëse I prodhoni ju si bashki. Ligji I ka të saksionuara. Duke e parë më të detajuar pbuxhetin. Ne e rrisim që të rrisim të ardhurat dhe të ardhmen..ne jemi pjesë e mirë e zhvillimit të qytetit. Na vini në vështirësi ekonomike.

Ermal Dredha: Faleminderit, keni ardhur për të diskutuar. Nuk po firmosim. Po dëgjojmë propozimet tuaja. Tavani është lartë. Taksa e infrastrukturës është dhe në Tiranë. Ligji do krijoj hapësirë edhe të paguaj me këste. Gati 12% është sipërfaqe e përbashkët, çfarënxjerrë hipoteka. Grupi I ekspertëve, operatorëve turistik dhe ndërtimit do diskutojnë dhe do konsultohemi me ju.

Geron Gumbardhi: Faleminderit. Je bërë ekspert edhe ndërtimi. Portit si marrin asnjë taksë dhe për qytetarët e Vlorë shtohet 3%. Për ndërtuesit e ka cuar 8%. Ngrini portit 12% dhe lijani qytetarëve 4%. Kam një propozim. Me provë 6 muaj. Sa leje do jepen me 4% dhe sa do jepen me 6%? Urbanistka të shikoj taksat dhe zbatoni ligjin. Venë në prokurori se nuk marrin leje. Taksa e plazhit, ngrihen kostot për turistët. Jo vetëm hoteleria. Leja e ndërtimit të zhvillohen ne sasinë dhe cmimin real. Të rriten taksat por tju ofrohet shërbimi qytetarëve. Nëse taksat rriten ku do shkojnë qytetarët të bëjnë plazh public?

Pyetje KB: Taksa e infrastrukturës sa rëndon te bizneset e licencuara? Të rriten projektet. Ky 6% vazhdon në rradhën e dytë, u shtohen dhe 3% të pastrehëve. Cmimet janë rritur. Prandaj duhet të bisedohet nga afër me punonjësit e administratës. Janë shumë probleme kërkojmë që bashkia tëna ndihmojë.

Gëzim Capoj: për të mos e zgjatur jam dakort me ato që tha Vasili, do të donim në filli draftin. Taksa e pastrimit duhet argumentuar, neqoftese mbetjet do të shkojnë në landfill.

Ky takim të shoqërohet me grupe më të vegjël pra nga turizmi, ndërtimi, teknikë. Ndonjëherë e gjitha kjo flas në emër të biznesit, them që rritja e tij me ritjen e cilësisë është normalitet. Duhet organizuar takime të ngushta.

Anjeza Shiko: të vazhdohet me tarifa e tjera. Dokumenti I paketës fiskale ka vetëm disa ndryshime saktësime-37%.

Te tarifa e pastrimit, materiali që do tju vijë, rritja nuk është e lartë, nuk ka ndonjë ndikim.

Tarifa e infrastukturës rritet në vlera

Tarifa e hapsirës publike shtohen në 42 mil lekë për tu kthyer në investime.

Tarifa e hapsirës publike kemi shtuar një zonë, rr transballkanike, rruga e plazhit të vjetër sipas përdorimit për gjatë gjithë vitit, rritje 100 lekë.

Rritja etavanit në 250mijë lekë me këste.

Bulevardi nga 400-500 lek kur përdoret gjithëvitim, për ambientet e mbyllura nga 300-400.

Ervin /Biznes: Ne për SPL kemi kërkuar ulje ju bëni ngritje. sa kushton 100m2 në Lungomare për të gjithë vitin?

Anjeza Shiko: Ishte 3 bëhet 4 pra 100x4x12 muaj.

Ervin/Biznesmen: kanë bërë kontrata për të paguar për 6 Muaj. Taksa SPL është shtuar, janë future ambientet e perbashketa.

Anjeza: Secila taksë është me vete. Hapësirat publike dhe hapsirat e përbashkëta pra kalon në bashkëpronësi.

Ervin: Kemi bërë shumë kërkesa për ulje të SPL

Anjeza Shiko: Metodologjia e krahasimit është kudo në botë.

Ervin: Ne taksohemi njësoj me Tiranën. Në qoftëse do rritet taksa do rriten dhe cmimet.

Anjeza Shiko: Është tarifë ,jo taksë.

Ervin: Në fund të fundit do e paguajmë.

Ermal Dredha: Më pëlqejnë debatet sepse mësojmë. Nuk është ndonjë rritje e madhe, por minimale është. Edhe cilësia e shërbimit duhet të rritet, qyteti duhet të rritet të zhvillohet. Do ketë dhe rritje të tarifave që të rriten dhe shërbimet, të gjithë kërkojnë shërbime më të mira në infrastrukture, ujin epijshëm, kanalizime. Në fund të fundit për të përmirësuar shërbim. Do kemi një oponencë këshilltarësh, do japin mendimin e tyre. Ne të paktën tentojmë. Jane rritur territoret. Duhet të bëjmë shumë punë. Pra ka gjera të përmirësojmë si shërbim. Duhet të marrim dakortësinë nga biznesi.

Biznesmen: A keni futur në buxhet rrugën e Fshatit të Tragjasit?

Ermal Dredha: E kemi bërë projekt.

Vasil Bedini: Ju zoti kryetar keni qënë dhe më parë dhe kemi diskutuar. Në lidhje me materialin që do na dërgoni në mënyrë elektronike. Duam info. Bashkia e re duhet ta dijë.

Ermal Dredha: E them sqerisht, skemi cte fshehim, nëse nuk e merrni infon. Ju premtoj që nga 2024 të bëjmë punët. Në qoftëse nuk jeni të kënaqur me draftin që do ju vijë.

Grigor Dede: Të gjithë diskutojnë, qëndrojnë. Një bashki duhet të ketë autonomi, dhe që të ketë autonomi duhet...Bashkia Vlorë nuk mund të krahasohet. Në analizën që u bë duhet të ishte përdorur dhe një metodë statistikore, politik shërbimi që i ofrohen qytetarëve, efektët negative. Pra nqse do të ishin më të qarta këto. Bashkia do të jetë më e pavarur kur ka të ardhura të mira. Cdo gjë të jete transparente. Nuk jam kundra rritjes së taksave dhe tarifave. Analiza të ishe me transparente, jot ë përmendet metodologjia e krahasimeve.


Irena Toshkallari: Sigurisht qe ka relacion të hollësishëm që do ta kemi para mbledhjes së këshillit. Do të kemi një kalendar të hollësishëm.

Klodian/ Biznes: Detyrim ligji, dëgjese publike, ku të ketë trasnparencë. Kemi prek vetëm sektorin e ndërtimit. Sëmundja më e madhe është shpopullimi, ku jeni të prekura të gjitha. Biznesi të ketë më shumë frymëmarrje, të jemi konkurent me shtetet e tjera.

Irena Toshkallari: Janë prekur vetëm ato që kanë ndryshime. Kjo është një dëgjese për tju treguar qytetarëve impaktin. Mos të përdoret politikisht. Familjeve nuk ju është rritur asnjë tarifë.

Klodian: Rritja e taksës së ujit, vetëm e rrisim por nuk përmirësojmë shërbimin.

Ermal Dredha: Nuk e di pse këto projeksione. Puna e tarifës së ujit. Ideja është që ky proces do ndodh. Ujësjetllësi në cdo qytet, Vlora ka tarifata më të ulta. Flasim për turizëm. Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm rrjeti do...Pra smerret shërbim pa paguar gjë. Proces që shkon nëzhvillimin e qytetit. Jemi këtu për të qënë transparent. Është vetëm informues, me grupet e interesit do të mblidhemi. Të jemi një dorë sa me e shtrenguar, jo abuzive. Nuk jemi vendimtarë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

DËGJESË PUBLIKE

“MBI PAKETËN FISKALE ME SHOQATËN E NDËRTUESVE NË VLORË”

Data 24.11.2023: ora 17.00

Në Pallatin e Kulturës ”Labëria”

Marrin pjesë:

Ermal Dredha/Kryetari i Bashkisë Vlorë; Elpiniqi Mërkuri/Kryetare e Këshillit Bashkiak;
Anëtarë të KB; përfaqësues nga shoqëria e ndërtuesve .

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha:

Përshendetje!

Ju falënderoj për pjesëmarrjen. Për atë çka lamë, mund të bëjmë dëgjesë me një grup më të ngushtë. Të shohim të gjitha zërat, të mos çenojmë bizneset. Dinamika në qytet kanë ndryshuar. Me ndërtimin e aeroportit që do sjellë zhvillimin, do ketë dhe zhvillim të infrastrukturës në këtë zonë. Për gjithë ndërtuesit, do tarifohen vetëm sipërfaqet e ndërtimit. Flas për të gjithë në këtë tryezë. Ka dinamikë qyteti, po merr zhvillim, harta është zgjeruar. Këtë e tregojnë dhe makinat teknologjike që qarkullojnë në qytet, por ka dhe kosto.

Nuk ka imponim, ku ka bashkëpunim. Ju si biznese kontriboni për qytetin. Jeni afruar dhe keni dhënë kontributin tuaj. Ju falënderoj! Të shikojme ti bëjmë zonale, mos harroni që Vlora për 10 vjet, do ndërtohet dhe do shtrihet. Të paktën të kemi mëndësi të bëjmë biznes. Zëri juaj është shumë i rëndësishëm.

Klaudio Mehmeti: Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, Bashkia Vlorë ka propozuar për ndryshime në dy fasha.

- 1.Zgjerim i fashës në Lungomare deri tek Tyneli..., Lungomare II dhe nga Skelë-Petrolifera.
2. Pika 1 ; 2 -Fshati Kaninë; Orikum.

Pjesa tjetër nuk ndryshon, hotelet kanë përparësi tarifën e aplikimit. Taksa e ndërtimit në infrastrukturë ndikon në buxhetin e Bashkisë Vlorë. Çmimi i referencës ka qënë 4%.

Në Radhimë dhe njësinë Orikum.

Projekt ide, Lungomare-Pyll i Sodës, kemi bërë krahasimin me të ardhurat nga Drejtoria e Urbanistikës.

Nga 285 milion, realizon 180.

Për vitin 2022 ishte planifikuar 298 dhe realizuar 315, tej planifikimit tonë.

76% kemi arkëtuar, taksa e ndikimit në infrastrukturë, 4% dhe 8%.

Pyetje/Biznes: Dy janë hallkat kryesore të bashkëpunimit, me ndërtuesit dhe turizmin. Pra sa me 4%, sa me 8%, dhe sa me 6% që pretendon kryetari.

Ermal Dredha: Janë objekte që një faqe e kanë nga deti. Fasha e 4% që propozojmë të bëhet 6%. Për pjesën 8% nga Petrolifera-Plazh i Vjetër për qëllim banimi është 8%. Nga tyneli 6%.

Klaudio Mehmeti: Kaninë dhe Zvernec skemi pas zhvillim.

Piro Stefa : Një sygjërim. Sa potencial, sa efekt kanë ndërtimet me 6% në fshatin Kaninë dhe Zvernec. Keni vënë shumë pika.

Ermal Dredha: Kjo mund të ndahet si zona 1,2,3. Kjo mund të shikohet. Kanina ska filluar akoma, as Zverneci. Pra ta bëjmë me zona. Edhe me sygjërimet tuaja.

Klaudio Mehmeti: Petrolifera-Tyneli me 8%. Ky është propozimi ynë.

Shkëlqim Leskaj. Për investitorët strategjik pse duhet të jetë me 4%. Atëherë konkretisht sa %..

Arben Breshani: Lungomare me 8% pjesa tjetër me 4%. E gjithë Vlora të bëhet 6%. Pra të mendohet me zona me 4%, 6% dhe 8%.

Altin Karalliu: Jam tek zona strategjike me 8%; 3% i të pastrehëve, tvsh,... fitimi pra 50. Ne prodhojmë m², ndërtim. Në zonën me 8%, 2000 euro/m².., ne arkëtojmë 1m². Ne 50% e japim. Me një ndërtim me kosto elitare, me të gjitha sistemet do 750 euro m², llogarit.. ngelet 250 euro. Pra, unë mendoj .., po përgatit për sistemin ndërtimit.. Tek zona me 6% kemi lidhur kontrata me pronarët, po kështu në zonën me 4% ka disa shërbime.. Pikat 1,3 ...do aplikohet..(Lexon) për zonat 3,5,7. Mungon zonimi me akse rrugore dhe të mirëpërcaktuara.

Ermal Dredha: Është çështje përmirësimi. Zonimin e thamë. Na jepni një propozim, pra kush zonë nuk mund të preket dhe, kush do jetë me 6%. Ideja është ta ndajmë sic duhet, jemi transparent. Çoni propozimet tek Kryetari i Dhomës së Tregtisë. Të biem dakort, sillni propozimet.

Piro Stefa : Dhoma e Tregtisë dhe Ndërtuesit...

Klaudio Mehmeti : Të vijmë dhe të diskutojmë.

Altin Karalliu: Zyra e Urbanistikës e ka të gjithë kapacitetin, të bëjë hartën.

Ermal Dredha: Kanina është e ardhmja e qytetit. Nëse është ndërtuar deri tani në Vlorë, është kaos. Pra të ndërtohet pa gabime, potencial ekonomik i qytetit janë dhe Kanina, Zvërneci, Radhima. Do ti shërbejmë njëri tjetrit.

Adhurim Duka: Janë rritur kostot për shërbimin e qytetarëve.

Piro Stefa : Bizneset duan një takim me Drejtorin e Urbanistikës.

Altin Karalliu: Jemi dakort që Vlora të ketë ndërtime strategjike.

Ermal Dredha: Zoti Arben, propozimet që do vinë tek ju të jenë me vizion.

Arben Breshani: Shoqatën kemi menduar ta ristrukturojmë.

Erma Dredha: Sa është taksa në bulevard, pas prishjes së pallateve të vjetra, flas si zona.

Altin Karalliu: Çelësi është paraqitja grafike, duhen teknike të mirë.

Klaudio Mehmeti: Takohemi te salla e mbledhjeve me grupin dhe propozimet tuaja.

Rubin Hekurani : Rruga kryesore me 6%, që të zhvillohet, të ulet taksa.

Arben Breshani: Lëmë, vendosim një grup të shkojë në bashki.

Ermal Dredha: Sillni propozimet konkrete tek Klaudio. Bashkia çtë mundet, aty ku gjykojmë që shkojmë,..si doni të zhvillohen etj.. Pjesën deri në 12 kate do ta diskutojmë.

Arben Breshani: Jemi për lartësi.

Ermal Dredha: Arkitektët duhet ti gjeni shume të mirë. Zonën rreth pallateve e bëni.

Presim propozimet zyrtare. Faleminderit!